

VENDIM

Nr. 332, datë 6.6.2018

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 547, DATË 9.8.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në fund të paragrafit "- Monitoron kontratat koncesionare për hidrocentralet" shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penalteti, vlerësimi do t'i referohet mesatares së prodhimit të energjisë, duke filluar nga viti i parë i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralit.".

b) Në fund të pikës shtohet paragrafi si më poshtë vijon:

" - Ndjek procesin e vlerësimit të investimeve të kryera për projektet e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike, në bashkëpunim me ekspertë vlerësues të pavarur, të caktuar nga ministri përgjegjës për sektorin e energjisë. Autoriteti kontraktues miraton raportin përfundimtar të vlerësimit. Shpenzimet për pagesën e ekspertëve vlerësues për llogaritjen e investimeve do të mbulohen nga subjekti që realizon projektin e ndërtimit të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike.".

2. Procedurat e hollësishme për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, miratohen me udhëzim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi